

Titulli i Projektit:

Grate si burim per zhvillimin lokal dhe demokratik te qytetit te Shkodres dhe te qytetit te Podgorices.

Donatore:

Komisioni European, Programi Rajonal CARDS 2003, Programi per Zhvillimin Lokal te Shoqerise Civile.

Zbatues:

COSPE, Cooperazione per lo Sviluppo dei Paesi Emergenti

Partnere:

1. Qendra e Gruas "Hapa te Lehte" (Shoqate shqiptare-Qyteti i Shkodres)
2. SOS-Hotline per grate dhe femijet viktime te dhunes (Unioni Serbi-Mal i Zi, Qyteti i Podgorices)
3. Shtepia e Grave ne Piza (Shoqate Italiane-Qyteti i Pizes)

Vendi:

Qyteti i Shkodres (Shqiperi) dhe qyteti i Podgorices (Mal i Zi)

Kohezgjatja:

18 Muaj duke filluar nga 15 Marsi-15 Shtator 2006

Projekti synon qe te forcoje procesin e demokratizimit dhe te pjesemarrjes ne qerisje te grave ne qytetin e Shkodres dhe te Podgorices, te cilet jane duke kaluar neper procese te veshtira sociale, politike dhe ekonomike te tranzicionit.

Objektivat e pergjithshem:

1) nxitja e procesit te demokratizimit, fuqizimit te grave dhe shpendarjes se kultures se pjesemarrjes ne qytetet e Shkodres dhe te Podgorices dhe 2) mbeshtetje proceseve te zhvillimit lokal ne qytetet e Shkodres dhe te Podgorices ne nje perspektive gjinore, demokratike dhe me pjesemarrje.

Objektivi specifik:

Rritja e nivelit te pjesemarrjes se grave ne proceset e vendimmarrjes ne nivelin formal dhe informal ne qytetet e Shkodres dhe te Podgorices.

Rezultatet Dhe Aktivitetet:

REZULTATI 1: Ngritja e nivelit te ndergjegjesimit per te drejtat civile te grave dhe ngritja e kapaciteteve te lidhshmit te grave ne lobbying ne qytetet e Shkodres dhe te Podgorices. Aktivitetet per te arritur kete rezultat jane:

Aktiviteti 1.1. Perzgjedhja e 200 grave qe do te perfshihen ne programet e trajnimit per te drejtat civile te grave.

Aktiviteti 1.2. Organizimi dhe zbatimi i programit te trajnimit per te drejtat civile te grave per 200 gra ne qytetet e Shkodres dhe te Podgorices.

Aktiviteti 1.3. Perzgjedhja dhe trajnimi i 40 grave lider ne lagjet e qyteteve te Shkodres dhe Podgorices ne temat e lobimit, **advocacy**, qytetarise aktive dhe monitorimi i politikave publike ne te dy qytetet.

Aktiviteti 1.4. Trajnimi i 30 grave nga institucionet lokale te te dy qytetet per te drejtat e grave, politikat gjinore, praktikat me te mira per te nxitur qortunitete te barabarta midis grave dhe burrave.

Aktiviteti 1.5. Zbatimi i nje plani me pjesemarrje per zhvillimin lokal ne nje perspektive gjinore ne qytetet e Shkodres dhe te Podgorices te perpunuara nga grupet e trainuara te grave ne bashkepunim me institucionet lokale.

Aktiviteti 1.6. Zbatimi i nje fushate ne te dy qytetet me temen: "Si eshte qyteti i imagjinuar dhe i deshiruar nga grate?"

REZULTATI 2: Perfshirja e institucioneve lokale ne qytetet e Shkodres dhe te Podgorices ne iniciativat e shoqatave te grave per te zvogeluar dhunimin e te drejtave te grave dhe perjashtimin e grave nga proceset e vendimmarrjes. Aktivitetet per te arritur kete jane:

Aktiviteti 2.1. Organizimi dhe zbatimi i programit te trajnimit i drejtuar per 50 perfaqesues ne te dy qytetet (25 nga secili) nga Institucionet si Bashkia, Policia, Gjykata, Institucionet Shendetesore, Departamentet e Sherbimeve Sociale per temat e dhunimit te te drejtave te grave.

Aktiviteti 2.2. Krijimi i nje tavoline te perhershme Inter-Institucionale ne qytetin e Podgorices per ceshtjet e dhunes ndaj grave dhe te femijeve me aktoret lokale te interesuar per kete problem: Bashkia, Policia, Gjykata, Institucionet Shendetesore, Sherbimet Sociale, perfaqesues nga Shoqata SOS-Hotline.

Aktiviteti 2.3. Forcimi i zyres se gruas ne Bashkine e Shkodres duke perdorur marredheniet e mira te ndertuara ne keto vite ndermjet Bashkise se Shkodres dhe Qendres se Gruas "Hapa te Lehte" per t'i dhene jete Zyres se Gruas ne Bashki, duke perfshire edhe shoqata te tjera ne teritor.

REZULTATI 3: Krijimi i nje sistemi shkembimi i praktikave te mira te identifikuar per te zvogeluar dhunimin e te drejtave te grave dhe perjashtimin e tyre nga proceset e vendimmarrjes. Aktivitetet per te arritur kete jane:

Aktiviteti 3.1. Dy konferenca lokale te hapura (nje per qytet) qe do te organizohen mbi problemet qe e mbajne gruan jashte problemeve demokratike dhe atyre te vendimmarrjes.

Aktiviteti 3.2. Krijimi i dy qendrave dokumentare mbi te drejtat e grave dhe politikave gjinore te vendosura brenda dy qendrave te grave, partnere te projektit.

Aktiviteti 3.3. Organizimi i nje konference rajonale ne qytetin e Podgorices per rolin e gruas ne procesin e tranzicionit ne vendet e Ballkanit.

Aktiviteti 3.4. Organizimi i nje konference nderkombetare ne Shkoder per grate, demokracite ne zhvillim ne Europe.

Aktiviteti 3.5. Realizimi i nje publikimi final dhe i nje videoje per aktivitetet dhe rezultatet e projektit.

Perfituesit E Drejtperdrejte nga projekti i propozuar jane: 200 gra ne tre lagjet ne te dy qytetet, 30 gra nga institucionet lokale te te dy qyteteve (15 gra per qytet) qe punojne ne institucione ne nivel lokal me funksione te ndryshme dhe pergjegjese per planifikimin dhe drejtimin e burimeve te qytetit, 20 gra aktiviste te shoqatave te grave ne Shkoder, 1000 gra per cdo qytet te cilat do te marrin pjese ne aktivitetet e lidhura me fushata dhe konferenca, 30 gra aktiviste te shoqatave te grave ne Rajon dhe ne Europe te perfshira direkt ne te dy konferencat, 50 persona per te dy qytetet perfaqesues te institucioneve si Bashki, Polici, Institucione Shendetesore, Departamenti i Sherbimeve Sociale.

Perfituesit Jo Te Drejtperdrejte jane komunitetet e grave ne te dy qytetet te cilat do te perfitojne nga nderhyrja, meqe aktivitetet do te forcojne dy shoqatat e grave partnere te projektit, sherbimet dhe kapacitetet e tyre per te dialoguar me institucionet lokale dhe do te influencojne ne politikat publike si edhe do te nxisin veteorganizimin e grave ne cdo nivel institucional. Perfitues jane gjithashtu edhe pjesa tjeter e banoreve.